



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KATËRT TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.04.2019 (e Enjte)**, në Zyrën e Drejtorit të Administratës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyra për barazi gjinore dhe përfaqësuesi i KDI-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e katërt të rregullt të KPF-së për këtë vit. Ju njoftoj, që MAPL-ja naj ka konfirmu pjesën dërmuese të ligjshmërisë së akteve, po një naj ka kthyer në rishqyrtim, vendimi që e kemi marr për ngritjen e shtatores “Safer Rexhepi”, i cili nuk është konform ligjeve për shkak planit zhvillimor urban, që nuk janë konsultu me këtë plan, dhe unë kërkoj nga drejtoritë, që të konsultohen paraprakisht dhe mos të naj sjellin propozim vendime pa u konsultu. Ju informoj, që edhe nesër e kemi një agjendë në 20 vjetorin e ramjes së dëshmorit “Mejdi Korrani”. Mirë është si anëtar të kuvendit të jemi prezent. Tani kaloj në pyetje dhe përgjigje jashtë rendit të ditës. Pasi që nuk ka, për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e KPF-së**
- 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2019**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen qytetar nderi ish Presidentin e Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani.**
 - a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nder komunal me Komunën e Kllokotit në fushën e infrastrukturës rrugore.**
 - b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunimin nder komunal me Komunën e Kllokotit në fushën e infrastrukturës rrugore.**
 - c) Propozim vendimin për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Kllokotit për bashkëpunimin nder komunal me Komunën e Kllokotit në fushën e infrastrukturës rrugore.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit me nr. 01-410/03-129 i datës 28.02.2018 për formimin e komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit me nr.01-410/03-71 të datës: 08.02.2018, të KKSB.**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve.**

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë
8. Informatë (raport) mbi punën e Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
9. Informatë për Manifestimin Flakadani i Karadakut edicioni XVIII
10. Informata për KEDS-in.

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm?

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket rendit të ditës, në koordinim të përbashkët me koleget e mij, materiali është shume i ngarkuar dhe kemi kërkesë që të largohen pikat e rendit të ditës, pika 2, 9 dhe e 10, me arsyetim se është material i ngarkuar.

z.Jakup Demiri: Te pika nr.11, informatë për KEDS-in. Në mbledhjen e kaluar ne kemi thanë, që në mbledhjen e ardhshme, me ardh propozim vendimi, mirëpo ky propozim vendim nuk ka ardh dhe unë propozoj që edhe kjo pikë mu hek krejt dhe me na ardh ai materiali.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kjo mbledhje e KPF-se ka material bukur voluminoz, po me gjithat këto tri pikat që po konsiderojnë se duhet të jeken, tu fillu prej pasqyrave financiare, informatë mbi punën e komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave dhe informata për manifestimi e “Flakadani të Karadakut”. Konsideroj që ne aspektin e udhëzimit administrativ gjithherë unë thamë, se në këtë kohë duhet të shqyrtohen pasqyrat financiare, bile bile kemi marr vërejtje nëse i shtymë në muajin majë, pika e 9 është një komision që e keni zgjedh ju vetë. Ky komision e ka obligim të sjell një informatë lidhur me procesin që kanë kalu. Me lan për më vonë këtë informatë, nuk e ka ma at kuptimin e vetë. E njëjta është edhe për informatën e “Flakadani”. Në rast që dojmë me punu, unë konsideroj që ka elemente që mujmë me punu, por nuk janë pika që nuk mundet mu shqyrtu. Po prapë jeni ju ata që vendosni, por unë nuk jam idhëtar i asaj, që pasqyrat të shtyhet e tani nga auditimi të marrmi rekomandim, pse i keni shqyrtu në muajin Maj e jo në Prill, ku materialin e keni këtu. Informatën për KEDS-in. Unë ju kam thanë atë ditë, që materialin do të ju dërgoj në emialadresë dhe ju kame dërguar.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Sa i përket shtyrjes së pikës nr.2, pasqyrat financiare. Ligji na thotë, që çdo herë na obligon, që 15 ditë pasi të kalon afati i periudhës së pasqyrave financiare, ne duhet me paraqit para KPF-së dhe Kuvendit Komunal. Na në këtë rast jemi me kohë, i kemi bë, ju mbetet juve të vendosni, e nëse shtyhet për muajin Maj, të jeni të vetëdijshëm, se kemi me pas rekomandim edhe nga auditori, edhe nga institucionet e tjera që e kemi tejkalua afatin. Me pas arsye pse me shty, se përndryshe ne jemi në rregull me kohë.

z.Jakup Demiri: Ne i kemi potencu shumë sene dhe i potencojmë prapë, te vendimet gjyqësore, vetëm janë të cekur vendimet e gjykatës, nuk i dimë cilat vendime ose shpenzimet e tjera, këto bile me i saktësu cilat janë shpenzimet e tjera, furnizim të tjera.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ne ju kemi dhënë informatën për vendimet gjyqësore, zyrtarisht e keni marr.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë ju lus miqësisht, që ta kalojmë këtë pikë, pasqyrat financiare, pasi që janë afatet ligjore, t'i debatojmë në këtë mbledhje, ndoshta edhe për neve si KPF që të kemi, pasoja nga auditori për shkak se, si komitet nuk i kemi shqyrtu, ndërsa nëse ka vërejtje rreth pasqyrave, ato munden të plotësohen për në kuvend.

z.Jakup Demiri: Ne përfaqësojmë subjektet, zakonisht mbledhjet i mbajmë para KPF-se, kemi shumë vërejtje, e ku e kemi edhe një si subjekt, një vendim që nuk kolon kjo kështu.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Çdo subjekt politik e ka konceptin e vet të punës, po një çështje duhet ta kemi të kjart, që pasqyrat financiare nuk votohen, shqyrtohen, prandaj të gjithë ju që jeni të interesuar për material shtesë, ju mundeni me marr, po nuk është në rregull që mos me shqyrtu me kohë e me marr rekomandim ne që nuk e kemi shqyrtua me kohë. Nëse ju si VV jeni që nga auditori të marrmi rekomandim, se nuk e kemi shqyrtuar ne muajin Prill, ju shtynë. Unë konsideroj që nuk është një çështje e drejt e juve si këshilltar komunal të veproni kështu.

z.Jakup Demiri: Te informata e KEDS-it, ne nuk kemi kërku informatë, po atë dite e kemi bë propozim vendimin, të cilin e keni marr të gjithë nga nja, po ju atë nuk e keni sjellë, po e keni sjellë informatën.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Duhet të keshyrmi se a jeni konform dispozitave ligjore të ai propozim vendim.

z.Bekim Azizi: Te informata e KEDS-it, duhet të vjen vendim për ndalimin e vendosjes së orëve në shtyllat elektrike. Disa komuna e kanë marr vendimin, që edhe MAPL-ja e ka kthly vendimin e ligjshëm, konkretisht Komuna e Podujevës e ka bër këtë vendim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Bekim, krejt po dakordohemi, që është një çështje që duhet të veprojmë, se kurrkush nuk po thotë që nuk duhet, edhe ne ndoshta e bëmë në seancën e radhës. Unë po ju lus, që është mirë që pasqyrat financiare t'i diskutojmë pasi që dëmtomi ne përfitimin e grandeve të ndryshme, ndërsa pikat tjera i hekmi nëse ju kërkoni që me i terjek.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Kërkojnë nga ju që të diskutohet, sepse këtu nuk ka asgjë të keqe në këto pasqyra financiare. Ne, këto pasqyra financiare i përgatitmi në bazë të rregullave të Ministrisë së Financave, Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, i bëjmë qysh thotë ligji, kurse sa i përket pjesës shtesë, nëse kërkoni diçka, at ju sjellim, atë e sigurojmë qysh jav kemi siguru vendimet gjyqësore, si e keni kërkuar ju.

Drejtori z.Milot Lala: Përshëndetje! Kisha pas dëshirë ta di një arsyetim nga ana e përfaqësueses së VV-së, pse po kërkon me hek nga rendi i ditës Informatën për manifestimin e "Flakadanit të Karadakut", tu e pas parasysh se aktivitetet mbahen në Mars dhe raportimi çdoherë me kohë është bër në muajin Prill, keshtu që unë po e shof jo të drejt nëse e shtym për seancën tjetër, po e hup at vlerën e raportimit.

znj.Liridona Bislimi: Materiali është voluminoz dhe pasi që është si informatë nuk qon pesh shumë nëse diskutohet me vohen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Materiali është voluminoz, po për qata e marrmi nga nja 200 euro për me i shfletu materialet. Atëherë unë obligohem me e qit në votim. Kush është me propozimin e Liridones, që të hekën pikat nga rendi i ditës. Me shumicën e votave hekën nga rendi i ditës pika 2,9,10 dhe 11. Tash e qes ne votim miratimin e rendit të ditës me pikat e mbetura. Nga të gjithë u miratuan pikat e mbetura të rendit të ditës.

Si pikë të par të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A ka dikush ju lutem rreth kësaj pike? Konstatohet se me vota unanime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen qytetar nderi ishe Presidentin e Republikës së Shqipërisë z.Bujar Nishani

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Është një iniciativ që Bujar Nishani ka shpreh gadishmerin që do të jete në muajin Qershor, do ta viziton Komunën e Vitisë. Kjo besoj që i bën nder shumë personaliteteve dhe besoj që kemi nderin që Kuvendi Komunal me e shpall qytetar nderi, nese ju jeni pro.

z.Bekim Azizi: Është hera e parë që e shpallim një qytetar nderi shqiptar, është diçka e mirë, mirëpo deri tashti kemi diskutu, që kur të vjen një propozim vendim, me na ardh një biografi për këtë, një arsyetim. Prapë vjen i njëjta pa arsyetim. Unë vetëm me këtë propozim vendim, nuk muj me e votu. Nëse seancën e ardhshme e sjellni biografinë, atëherë e votojmë, unë jam kundër kështu.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë e qes në votim. Kush është që të shkon ne kuvend? Me 3 vota pro dhe 4 kundër, nuk shkon as kjo pikë e rendit të ditës në kuvend.

Si pikë të tretë kemi:

3. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit nderkomunal me Komunën e Kllokotit në fushën e infrastrukturës rrugore.

b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës se kryetarit të Komunës së Vitisë për bashkëpunimin nderkomunal me Komunën e Kllokotit, në fushën e infrastrukturës rrugore.

c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë, për të filluar konsultimet me Komunën e Kllokotit, për bashkëpunimin nderkomunal me Komunën e Kllokotit në fushën e infrastrukturës rrugore

Kemi pas një takim para një javë dite me sekretare e Ministrisë së MAPL-së. Insistoj, që marrëveshjet nderkomunale të kalojnë në Kuvendet Komunale përmes nismës, në këtë rast e kemi në nja dy tre projekte, që janë me Komunën e Kllokotit. Është një trotuar që do të shkon nga rruga Pozharan-Kllokot, një nga Mugilla, dhe kanë kërk, që nisma të kalon në kuvend, në mënyrë se i kanë dikun 1 milion fonde ata të cilët ju ndaj komunave të Kosovës. E nëse këto nisma nuk kalohen përmes kuvendeve komunale, nuk kane të drejtë të

gëzojnë këto fonde dhe për këtë arsye e kemi prurë këtë nismë. Ne kemi pas edhe me herët bashkëpunim me Komunën e Klllokoti, e kemi bërë rrugën prej Skifteraj deri në Mogillë, po tash po e kërkojnë nismën që me kalu në Kuvend. Andaj kërkoj nga ju që ta miratojmë këtë nismë dhe të aplikojmë për grande. Unë hapi debat për këtë pikë.

z.Ekrem Abazi: Kësi nisma kemi pas edhe me herët, po është shumë interesant, se investimet që janë bërë për Komunën e Klllokotit dhe të Vitisë, Komunës së Klllokotit ja ka pagu ministria, a paret e tona gjysma dhe me tepër se gjysma, kanë shkuar prej të hyrave vetanake. Në çoftë se nuk vjen me shkrim, që një bashkëpunim ndërkomunal nuk paguhet nga qeveria të hyrat, unë nuk e votoj as sot as kurrë, se gjithmonë Komuna e Klllokotit po përfiton nga qeveria e ne si komune të hyrat vetanake i qojmë paret aty, d.m.th bile me tepër se ato që i jep ministria.

z.Jakup Demiri: Sa i përket buxhetit për kokë të banorit, Komuna e Klllokotit është shumë më e fuqishme se sa Komuna e Vitisë, duke i pas parasysh se edhe kur është nda Komuna e Klllokotit nga Komuna e Vitisë, 41% të buxhetit i ka kaluar Komunës së Klllokotit, ndërsa në projektet që janë punu, Komuna e Klllokotit nuk ka participu hiq fare në Komunën e Vitisë. Po ka edhe punë të Komunës së Vitisë që janë bërë në territor të Komunës së Klllokotit edhe këtu është pak, se ne e kemi drohen të puna e ujit, e ujësjellësit. Unë jam kundër kësaj nisme.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: 41% kurrë nuk e kanë marrë buxhetin, harroje atë punë. Ata deri frikë sun e kanë mbulu as afatin e vetë. Është një realitet që ne e kemi krye projektet, të cilët nuk kanë qenë, si p.sh.: rruga Mugill Viti, gjithëherë konsideroj që janë qytetarët tonë edhe ata që i kemi atje, mirëpo tash me konkuru për fonde, kërkohet me pas një marrëveshje të bashkëpunimit. Në rast se ju po konsideroj që jeni kundër qatyre, e nëse kërkoni që qeveria me ardhje me javë prurë arsyeshmërinë juve. Harroni se ajo qeveria kurrë nuk e bjen atë, ata menxi presin që mos me miratu na këtë nismë. Ne jemi duke e bërë këtë nismë që të rregullojmë trotuarin me ndriçim Pozharan-Klllokot dhe Mugill-Viti, po nëse ju jeni kundër këtij propozim vendimi, pengone. Unë kam pas takim me nënkryetaren e Komunës së Klllokoti dhe unë ja kam propozu projektet, as që e kam pyet për projektet dhe ata e kalojnë këtë nismë në Kuvendin e Klllokotit.

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, kur u nda Komuna e Klllokoti me të Vitisë, ka qenë një dokument kur është kundërshtu ndarja e Komunës se Klllokoti mu bë Komunë në veti, të cilën e ka nënshkruar edhe një ish kryetar i komunës i komunitetit serb, për mos mu nda. U kanë një paragraf aty që ka shkruar, edhe harta u kanë aty, edhe të hyrat e Komunës së Vitisë pakësohen apo i kalojnë 41% Komunës së Klllokoti. Këtë dokument e kam pa unë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Jakup, nuk është bre ashtu, nëse buxheti i Komunës së Vitisë, 41% i ka kalu Klllokoti nga buxheti i Vitisë, unë nuk rri në Viti po edhe ti duhesh me qenë i kujdesshëm.

z.Jakup Demiri: Unë po themë, që kam pa dokument për këtë, nuk po e themë unë po e kam pa dokumentin.

z.Bekim Azizi: Unë e di që edhe Komuna e Vitisë ka investu në territorin e Komunës së Klllokoti, e sipas ligjit nuk mundesh me be investime në komunën tjetër, kjo është e ndalume me ligj, po për shkak që Zhitia, qytetarët e këtij vendi janë lidh me Viti, as ne nuk e kemi diskutu kurrë këtë. Ose rruga që është be Mugillë-Viti, ka kalu në territor të Komunës së Klllokotit, po janë lidh qytetarët tanë dhe nuk e kemi diskutu. Tashti e kemi një informatë, që edhe disa fshatra të Klllokoti mu lidh me ujësjellësin në Viti. Kjo ka me peng procesin e Ujësjellësit në Viti. Janë do dilema, që nuk na le me e diskutu, po për mendimin tim, të trotuaret Viti-Klllokot pa u bërë zgjerimi i rrugës katër trakësh, ne nuk guxojmë me hi. Mendoj që kjo është jo në rregull. Unë mendoj që duhet të ketë zgjerim të rrugës magjistrale, rruga për Pozharan, duhet të mendojmë në afat më të gjatë. Kemi edhe raportin e kryetarit që e ka sjellë tash, e ku thotë, që është zgjeru rruga prej Drobeshit në Mogillë. Le të zgjerohet kjo rrugë njëherë, tani shkojmë me tretuar.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Nëse nuk kemi marrëveshje bashkëpunimi, automatikisht nuk fitojmë donacion. E nëse jeni rreshtu kundër Vitisë, nuk ka problem, mos e votoni, ministria menxi që pret, në Prishtinë nuk diskutohet atje se çfarë partie është, nuk e ki marrëveshjen, atje bjen.

z.Ekrem Abazi: Bekimi e tha, që ajo rrugë duhet mu zgjeru. Tani me bërë trotuarin me shtrë tash trotuarin e mas dy tri vite me hek, aty po shko njersa e qytetarëve, po me doket e pa tolerueshme. Për mu, më mirë është mos me kalu, me mirë është që ato pare ti merr një komunë që nuk e hek at trotuar që e gëzojnë qytetarët.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Për me fitu donacionin prej ministrisë, duhet me votu këtë nismë dhe kërkoj nga ju, që të votohet kjo nismë dhe të vazhdojmë tutje që të konkurrojmë për trotuar dhe ndriçim.

znj.Xhilsime Qamili: Përshëndetje për të gjithë! Edhe unë pajtohem me disa parafolës, po me disa që paragjykojnë se qysh ka me qenë dhe çka, kur prishen dhe qysh shkojnë ato. Nuk po muj mu pajtu me ato, po unë mendoj që është një ndihmë shume e madhe të behet trotuari. Arsyen e mbështes në atë se e kemi një

komunitet shqiptar që jeton në Mogillë-Kllokot që i kryen shërbimet dhe ju lehtësohet puna. Mu mirr me paragjykimet, se si do të jet, a do të zgjerohet rruga, atëherë do të bëhet marrëveshja e cila më vonë do të vien këto gjera, e një nismë e tillë le të shkon.

Kryesuesi z.Naim Pira: Kjo është një nismë, nuk po flasim konkretisht për projektet, kjo është një nismë për me fillua që me bashkëpunu me ta. Projektet sigurisht që do të vinë në të ardhëm, që planifikohen me u bë, mirëpo po thamë që ministria po i kërkon qeto nisma, që me i fillu ne, se pa këto hiq nuk na le me konkuru në këto projekte, prapë është në dorën e juaj kjo.

z.Bekim Azizi: Pse nuk po ulni ju me Kllokotin me e bë projektin e përbashkët, me e propozu atë projekt, tani ne e marrim nismën e përbashkët për me e realizu këtë projekt.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi të kalon nisma, atëherë e kërkojnë projektin. Pasi nuk ka për të diskutuar, po e qes në votim, ju lutem që ta votojmë këtë pikë, ta qojmë për në kuvend, sepse nëse nuk votohet, po e dëmtojmë veten. Kush është që të shkon në Kuvend kjo pikë. Me 4 vota kundër dhe 3 pro nuk kalon kjo pikë.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit me nr. 01-410/03-129 i datës 28.02.2018, për formimin e komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne e dimë që u kemi dy asamblistë që kane shku në pozicione tjera dhe tashti KQZ-ja e ka bë certifikim e kandidatëve të tjerë. Jemi të obliguar që t'i ndërrojmë dhe ti ndryshojmë, propozim vendimin e keni marr me kohe. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm. Pasi nuk ka, po e qes në votim që të shkoj në kuvend për miratim. Konstatoj se me vota 4 vota kundër dhe 3 pro nuk kalon kjo pikë.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit me nr.01-410/03-71 të datës: 08.02.2018, të KKSB

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Fjala është për komandantin e Policisë së Stacionit Policor të Vitisë, z.Agim Lipovica, i cili ka shku me detyrë tjetër, ku në bazë të udhëzimit administrativ duhet me e ndërru.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm? Pasi që nuk ka, e qes në votim. Me votat e të gjithëve u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës e kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve

znj.Ibadete Hyseni: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Bazuar në Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe Statutin e Komunës, si dhe në bashkëpunim me organizatën ndero fëmijët, kemi hartuar rregulloren për themelimin dhe strukturimin e asamblesë komunale të fëmijëve, e cila rregullore ka për qëllim formimin e asamblesë komunale të fëmijëve, ku asambleja do të ketë në përbërjen e saj 27 anëtar përfaqësues të përzgjedhur nga të gjitha shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vitisë. Kjo propozim rregullore, do të jetë në diskutim publik deri me datën 30 Maj, ndërsa debati përfundimtar do të jete me 3 Qershor.

Kryesuesi z.Naim Pira: E hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Bekim Azizi: A e kanë komunat tjera këtë asamble të fëmijëve, sepse unë nuk kisha ndegju për këtë asamble, a janë fëmijët e shkollës fillore?

znj.Ibadete Hyseni: Po disa komuna e kane funksionale, si Gjilani, Kamenica, Gjakova. Po vetëm të shkollës fillore janë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim. Me 1 vote kundër, tjerat pro, kjo pikë e rendit të ditës shkon për në kuvend.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik për propozimin rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijë

znj.Ibadete Hyseni: Edhe kjo është një rregullore për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Kjo rregullore është hartu në bashkëpunim me koalicionin e OJQ-ve për të drejtat e fëmijëve, ku është në përbërje pre 37

OJQ-ve ne nivel vendi. Edhe kjo rregullore do të jete në diskutim publik, materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi diskutimin, nëse ka ndonjë pyetje. Pasi që nuk ka, e qes në votim. Kush është që të shkon për në Kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Me 1 votë abstenim, tjerat po, shkon për në kuvend kjo pik e rendit të ditës. Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë, mirë u pafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja përfundon në ora: 11:05

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë
z.Naim Pira
